



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

**KEC**



**PROJEKT  
PËR  
HARTIMIN E STRATEGJISË NACIONALE PËR  
MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS PËR  
PERIUDHËN 2006-2016**

/ DRAFT/



PRISHTINË, JANAR 2005

**“ARDHËMËRIA E KOSOVËS ËSHTË NJË  
GARË NDËRMJET: REALIZIMIT ,  
MBROJTJËS DHE TË FUQIZIMIT TË  
DREJTAVE TË NJERIUT- FËMIJËS DHE TË  
KATASTROFËS”**



## PËRMBAJTJA:

1.Korniza e përgjithshme.....	4
2.Katër etapa kryesore të hartimit, zbatimit dhe të vlerësimit të Strategjisë Nationale për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijës.....	10
2.1.Ekspertiza e gjendjes së drejtave të njeriut/fëmijës në Kosovë .....	10
2.2.Përpilimi Strategjisë nationale për fëmijë.....	11
2.3.Përgatitja e planeve të veprimit - pjesë integrale e strategjisë .....	12
2.4. Evaluimi.....	12
2.5. Komisionet , trupat dhe grupet e punës .....	13
3. Buxheti i nevojshëm për hartimin e Strategjisë nationale për fëmijët e Kosovës.....	17

## PËRMBAJTJA E AKRONIMEVE:

**GEP** – Grupe të Ekspertëve të Punës

**KEC** – KOSOVA EDUCATION CENTER

**KNDF** – Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës

**KNMDF** – Këshilli Nacional për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijës

**KNPVGJDF** – Komiteti Nacional për Përcjellje dhe Vlerësim të Gjendjes së Drejtave të Fëmijës

**MKL** – Metoda e Korinzës Logjike

**KSHMDF**- Komitetet Shkollore për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijës

**MKRDF** – Nënshillat Rajonal të Drejtave të Fëmijës

**KKDF** – Këshillat Komunal të të Drejtave të Fëmijës

**PNEDFNJ/F** – Programi Nacional I Edukimit për të Drejtat e Njeriut/Fëmijës

**PNEDNJF** - Programi Nacional për Edukimin për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijës

**OJQ**- Organizata Joqeveritare

**QAK** – Qendra për Arsim e Kosovës

**SNFK** – **Strategjia nationale e fëmijëve të Kosovës**

**SGNHSF** – Struktura e Grupeve Nationale për Hartimin e Strategjisë së Fëmijëve

**SHPK** – Shërbimi Policor i Kosovës

**DUDNJ**- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

## 1. KORNIZA E PËRGJITHSHME

1.1. Respektimi, zbatimi dhe garantimi i të drejtave të fëmijës në Kosovë në përputhje me **Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës - KNDF**; me Strategjinë evropiane për fëmijët<sup>1</sup>; me **Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut**; me Paktin ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike; me Paktin ndërkombëtarë për të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore; me Deklaratën botërore për mbijetesë, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve<sup>2</sup>; me Planin veprimit për zbatimin e Deklaratës në favor të mbijetesës, mbrojtjes dhe të zhvillimit të fëmijëve<sup>3</sup>; me Rekomandimet e Konferencës ndërkombëtare për eliminimin e pornografisë së fëmijëve në internet (Vjenë, 1999), *është një interes parësor nacional i Kosovës dhe i gjithë qytetarëve të saj, të gjitha bashkësive etnike, racore, gjuhësore, fetare, sociale dhe ekonomike*;

1.2. Respektimi, promovimi, ushtrimi i të drejtave të fëmijës duhet të përcaktohet me një Strategji nacionale të Kosovës; të kuptueshme, të qëndrueshme të koordinuar të orientuar drejtë zhvillimit të një **shoqërie – miqësore të fëmijëve**<sup>4</sup>...” një mbrojtjeje më të mirë të fëmijëve<sup>5</sup>.. dhe “...që do t’i promovonte interesat e fëmijëve<sup>6</sup>

1.3. SNFK, duhet të bazohet në faktin se edhe fëmijët e Kosovës, si të gjithë fëmijët e botës”... janë të pafajshëm, të lëndueshëm dhe të varur. Ata, po ashtu, janë kureshtarë; aktivë dhe plotë shpresë. Koha e tyre duhet të jetë e përmbushur me gëzim dhe qetësi, lojë nxënie dhe zhvillim. Ardhmërinë e tyre duhet ndërtuar në harmoni dhe bashkëpunim, **duke zgjeruar horizonte dhe duke fituar përvoja të reja. Jeta e tyre duhet të piquet<sup>7</sup>**”.

1.4. Në edukimin dhe në arsimim për të drejtat e fëmijës dhe për përgjegjësitë qytetare dhe demokratike duhet të fillohet nga supozimi se edukimi dukshëm mund të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së drejtave të fëmijëve dhe të demokracisë në të gjitha vendet

<sup>1</sup> Rekomandimi 1286(1996).Dok.8287 I dt.23 dhjetor 1998.Përgjigje nga Këshilli I Mistrave e miratuar nga Zëvendës – Ministrat më 15 dhjetor 1998

<sup>2</sup> Hyseni, H. dhe të tjerë(2004).: Të drejtat e fëmijës. Manual për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës, KEC, Prishtinë, ff.199-204

<sup>3</sup> Po aty, ff. 203- 208

<sup>4</sup> Shih: Strategjia evropiane për fëmijët, Kuvendi Parlamentar, Rekomandimi 1286(1996) f.1

<sup>5</sup> Po aty, f.3

<sup>6</sup> Po aty, f.3

<sup>7</sup> Deklarata Botërore për Mbijetimin, Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Fëmijëve

dhe në të gjitha shtetet. Koha postmoderne dhe procesi globalizmit i kanë detyruar, vendet, shtetet, popujt dhe kulturat e ndryshme në bashkëpunim. Vendet e largëta nën ndikimin e teknologjive të komunikacionit, bëhen të afërta. Kulturat dhe vlerat e ndryshme ndërthuren, vejnë kontakte, përballen me njëra tjetrën. Po kështu, ndodh edhe me format e sjelljes. Në këtë llojlojshmëri kulturore diferencohet dhe krijohet një gjuhë e re e cila mundëson të kuptuarit e njëvlerëshëm në llojlojshmërinë – diversitetin e kulturave të ndryshme. *Kjo gjuhë e përbashkët është gjuha e të drejtave të njeriut/fëmijës dhe të përgjegjësive të përbashkëta. SNFK duhet të komunikojë me këtë gjuhë.*

**1.5. SNFK** nuk mund të hartohet pa njohjen reale të tregeusve të cilit pasqyrojnë gjendjen ekzistuese të drejtave të fëmijës.

*Megjithëse mungon ë një ekspertizë objektive të bazuar në gjurmime të ndryshme, qofshin ato empirike, qofshin metaanalitike, teorike dhe fundamentale, ekzistojnë tregues të mjaftueshëm për të konstatuar se kjo gjendje nuk është e kënaqshme dhe nuk mund të sigurojë një zhvillim normal të Kosovës në të ardhmen, sepse:*

a. Vëzhgimet jo sistematike, në një anë, dhe, në anën tjetër, hulumtimet, qofshin ato të vogla dhe empirike a hulumtime të detajuara, raportimet dhe shkrimet në gazeta, raportimet e organizatave dhe agjencive të besueshme qeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare, fëmijët të cilit për çdo ditë i hasim në rrugë duke lypur dhe kërkuar lëmshë, fëmijët me të cilit takohem në lokale të ndryshme që merren me tregti të imtë, fëmijët që i takojmë në treg duke bartur mallra dhe që nuk vijojnë shkollat dhe institucione arsimore, janë tregues shumë të qartë të gjendjes tejte të vështirë të fëmijëve të Kosovës e cila gjendje edhe pse është avancuar pas luftës, ***sërish është në udhëkryq, nga i cili duhet dal me një vizion shumë të qartë, mobilizues, të realizueshëm, gjithëpërfshirës dhe në interes të fëmijëve të Kosovës;***

b. Numri i konsideruar i fëmijëve të cilit e braktisin arsimin e detyruar, po ashtu është tregues i qartë se shumë fëmijë nuk e gëzojnë të drejtën në arsimim me çka u pamundësohet zhvillimi normal i tyre në një anë, dhe në anën tjetër, këta fëmijë janë dhe në të ardhmen do të jenë akoma më shumë në një pozitë të diskriminuar dhe të

papërkrahur, sepse nuk do t'i kenë shanse dhe gjasa të barabartë për pjesëmarrje aktive në zhvillimet shoqërore (mendojmë se është i qartë edhe aspekti humanitar dhe moral i problemit në një anë dhe ndikimi i tij negativ për prosperitetin e përgjithshëm të Kosovës në të ardhmen);

c. Numër i madh i fëmijëve të cilit vuajnë nga çrregullimet e stresit pas traumatik \_ÇSPT që janë pasoja të luftës së zhvilluar në Kosovë dhe që kanë nevojë për rehabilitime dhe trajtime të veçanta, është po ashtu tregues i një gjendjeje të vështirë e cila manifestohet me vetëvrasjet e shpeshtuara në vitet e fundit. SNFK duhet ta ketë parasysh edhe këtë fakt.

ç. Numër i konsideruar i fëmijëve të Kosovës për shkak të luftës së zhvilluar ka mbetur pa prindër dhe pa përkujdesje të prindërve (fëmijët e dëshmorëve dhe të viktimave të luftës) dhe pa përkujdesje me dashuri. Këta fëmijë vulnerabël, kanë nevojë për përkrahjen më të madhe të shtetit dhe të institucioneve tjera. Kosova nuk ka këshillimore dhe institucione që mund t'u ofrojnë ndihmë fëmijëve të këtillë. A është e moralshme dhe njerëzore indiferenca ndaj këtyre fëmijëve? Po ashtu, shtrohet pyetja çfarë do të ndodhë me këta fëmijë kur ata të rriten, nëse rriten (të kujtojmë lidhjet e vërtetuar shkencore ndërmjet sistemit imunitar dhe nervor dhe të kushteve të punës si dhe të përkujdesjes me dashuri në anën tjetër, duke mos anashkaluar edhe problemet të cilat shoqëria ardhshme kosovare do t'i ketë, nëse sot nuk mendon për fëmijët e këtillë)?

d. Në Kosovë është një numër i madh i fëmijëve të varfër (16% jetojnë në varfëri të skajshme dhe rreth 40% jetojnë në varfëri). Varfëria e këtillë e lartë, në një anë, pamundëson zhvillimin e tyre të plotë psikik dhe fizik, ndërsa në anën tjetër, këta fëmijë janë në pozitë të diskriminuar me një perspektivë të paqarë dhe me gjasa të mëdha për humbje të imuniteti shëndetësor dhe me mundësi reale për orientime asociale dhe për një jetë me plotë sfida dhe probleme individuale dhe sociale si për veten, ashtu edhe për shoqërinë.

dh. Një numër i konsideruar i fëmijëve të Kosovës kanë ra ndesh me ligjin. Duhet rishikuar pozitën e fëmijëve të këtillë dhe analizuar etiologjinë e veprimeve dhe sjelljeve të këtilla të këtyre fëmijëve. Duhet analizuar punën në rehabilitimin dhe risocializimin e tyre pas përfundimit të procesit të riedukimit në burgje. Po ashtu, duhet shikuar

procesin i riedukimit të tyre në burgje, për të dhënë përgjigje që procesi i riedukimi të tyre të jetë i suksesshëm.

e. Pasiguria, liria e kufizuar e lëvizjes së qytetarëve ( në këtë rast edhe të fëmijëve) pengon krijimin e urave të mirëkuptimit, pamundëson integrimin dhe kohezioni social, nuk krijon hapësirë; për edukim ndër dhe shumë kulturor , për promovimin e rolit irenik të arsimit; përkundrazi krijon urrejtjen, pasigurinë, ankth të përgjithshëm individual dhe kolektiv. Është shumë e qartë se duhet gjetur mënyra për ta tejkaluar këtë gjendje fragjile, të pa sigurt dhe të pa pajtueshme me karakterin demokratik të shoqërisë të cilën e synojmë dhe të cilën duhet ta realizojmë.

f. Pozita e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve për arsye të ndryshme është e palakmueshme, për Kosovën në shumë aspekte e dëmshme dhe e pa justifikueshme. Një pjesë e fëmijëve romë, ashkalinjë dhe egjiptas jetojnë në kushte jo njerëzore dhe të rrezikshme për shëndetin e tyre ( në kampet në Plemetin dhe në Zveçan, në Dubravë e gjetiu). Kjo nuk është humane, bie ndesh me aspiratat edhe vullnetin e lirë të shprehur të qytetarëve të Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike, fetare, gjuhësore, etj.

Pjesë a dërmuese e fëmijëve romë , ashkalinjë dh egjiptas për shume arsye, nuk shkollohen dhe arsimohen. Kjo, për zhvillimin e ardhshëm të Kosovës do të jetë një pengesë e madhe sepse Kosova do të përballlet me ngecje ekonomike, sociale, arsimore, politike kulturore dhe etnike .

Po ashtu, kjo, pos që është një çështje humane dhe morale , është edhe çështje e zhvillimit të normal të Kosovës, kusht i domosdoshëm për integrimin e Kosovës në Bashkësinë Evropiane dhe në familjen e vendeve demokratike ?

g. Sistemi i tashëm arsimit ( me gjithë nismat e ndërmarra për ndryshime) në Kosovë nuk është nivelin i cili u mundëson fëmijëve zhvillim të plot; fizik dhe psikik, që i pajisë nxënësit me vlera njerëzore, nuk është i mishëruar me edukim dhe arsimim shumë dhe ndërkulturor, nuk i aftëson fëmijët që të mësojnë gjatë gjithë jetës, nuk ë formon shkathëtitë themelore jetësore, nuk ka vizion zhvillimor, nuk është përshtatshëm për miratimin e ndryshimeve, nuk ka bazë dhe infrastrukture të avancuar të qeverisjes dhe të udhëheqjes, nuk ka ndjeshmëri të duhur për të nxitur ndryshime, nuk ekziston konsensusi shoqëror e as strategji nacionale për ndryshime.. Në strategjinë Nacionale të Fëmijëve duhet të definohet qartë roli arsimit për zbatimin e të drejtave të fëmijës në

një, anë dhe në anën tjetër, arsimit duhet të strukturimet ashtu që ai të jetë i mirë për të gjithë fëmijët e Kosovës pavarësisht nga prejardhja etnike, racore, fetare, gjinore, sociale, gjuhësore etj. Me strategji nacionale duhet siguruar mekanizma me të cilat do garantohet cilësia në arsim.

gj. Baza e tashme juridike, infrastruktura dhe konfiguracioni ligjor, pavarësisht nga nismat premtuese<sup>8</sup> është joadekuat dhe jo i përshtatshëm për zbatimin dhe respektimin e plotë të drejtave të njeriut dhe të fëmijës, në një anë, dhe në anën tjetër mungojnë shumë ligje dhe akte juridike. Po ashtu, një pjesë e ligjeve që ka të bëjë me të drejtat e njeriut dhe të fëmijës nuk zbatohet ( p.sh. dispozitat për tekstet falas , etj). Me strategji duhet krijuar mekanizma të cilat do të mundësojnë zbatim efikas të ligjeve me të cilat do të mbrohen, respektohen, promovohen dhe fuqizohen të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijës në veçanti .

h. Mungesa e ligjeve dhe i dispozitave ligjore, moszbatimi konsekuent i tyre, shkalla e ulët e demokracisë, veprimet e ndryshme abuzive siç janë mitoja , korrupcioni, nepotizmi, politizimi dhe i arsimit, keqpërdorimi i tenderëve, mos transparenca kanë krijuar ambient të pa përshtatshëm për zbatim dhe respektim të drejtave të njeriut dhe të fëmijës, duke lejuar rritjen e kriminalitetit, dhunës, keqtrajtimeve, duke pamundësuar shërbimet dhe trajtimet e ndryshme shëndetësore, duke mbajtur gjallë mortalitetin e lartë të fëmijëve dhe të porsalindurve, duke e cenuar etikën dhe duke nxitur erozionin e moralit dhe duke atakuar moralin e institucioneve publike, duke i bërë ato jo kredibile dhe jo të besueshme . Të gjitha këto po e shkaktojnë erozionin e moralit, po e rrisin pabarazinë, po e godasin rëndë drejtësinë dhe ardhmërinë e qytetarëve të Kosovës. Me Strategji duhet gjetur zgjidhje për të siguruar edukim cilësor shëndetësor, sigurinë sociale, mirëqenien , lirinë dhe barazinë politike dhe civile; lëvizjen e lirë, besimin në institucione, veçmas në institucionet juridike, të sigurisë, prokurorisë, legjislativit dhe të ekzekutivit.

i. Kosovës i mungon Programi Nacional i Edukimit për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës, andaj shkalla e vet ndërgjegjësimit për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës nuk është në

---

<sup>8</sup> Janë miratuar disa ligje bazike për të Drejtat e njeriut, ( barazinë gjinore, familjen, Ligji për ndalimin e diskriminimit, etj) . Në procedurë është Ligji për të Drejtat e Fëmijës). Ekzistojnë edhe dispozita të tjera që lidhen me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës ( Korniza Kushtetuese e Kosoves, Ligji për arsimin fillor dhe të mesmem, ligjet tjera sektoriale etj)

nivelin që mund të bëjë tryzni në organet e pushtetit. Sikur jemi ambientuar dhe akomoduar me njerëzit- fëmijë parashkollor që lypin rrugës që shesin e që punojnë në tregje të ndryshme; me vajza që e braktisin shkollimin , me dhunën që përdoret në shkolla dhe institucione tjera shoqërore, me paragjykime dhe stereotipe ; me diskriminime e ksenofobi dhe me animozitet të tjera të cilat nuk lejojnë që Kosova t'i përmbush standardet e vendeve të vërteta demokratike. Me strategji për fëmijë duhet gjetur zgjidhje edhe për këto çështje shumë madhore.

j. Mediat në Kosovë në përgjithësi nuk punojnë në pajtim me Konventën për rolin e mediave në përhapjen e filozofisë së drejtave të njeriut dhe të fëmijës. Punimet e publikuara janë me karakter informativ pa ndikim të madh në opinion. Mungojnë artikujt analitik e hulumtues. Gazetarët nuk janë të aftësuar dhe të trajnuar për të përcelgjellur, studiuar dhe analizuar gjendjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës, andaj nuk janë as të rralla rastet kur nga këto mjete nëpërkëmben të drejtat e njeriut dhe të fëmijës për shkak të jo profesionalitetit , të ngarkesave etnocentrike, paragjykimeve dhe stereotipeve dhe të animoziteteteve të tjera të ndryshme. Me SNFK duhet gjetur zgjidhje të tilla qe mjetet e informimit të shndërrohen në instrumente të fuqishme të mbrojtjes, respektimit, promovimit dhe të fuqizimit të kontrollit, të monitorimit të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të fëmijës në veçanti .

k. Organizatat joqeveritare lokale , me gjithë kontributet e tyre në përmirësimin e gjendjes së drejtave të fëmijës, ende nuk kanë i shfrytëzuar të gjitha mundësitë;( puna e tyre shpesh herë shndërrohet na skema, bëhet formale, më shumë shërben si mundësi për të siguruar rrogë ca njerëzve se për të përmirësuar dhe avancuar të drejtat e njeriut dhe të fëmijës) për avancimin dhe fuqizimin e gjendjes së drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të fëmijës në veçanti. Nuk mund të mos e themi se në punën e organizatave të këtilla bashkëpunimi, transparenca; trajnimet bazike dhe të specializuara dhe edukimi për stafet e OJQ duhet të jetë në shkallë më të lartë. Përkrahja dhe trajnimi në terren duhet të avancohet. Përkrahja e vazhduar dhe këshillat duhet të avancohen. Shumë organizatave joqeveritare u mungojnë pajisjet dhe trajnimet; profesionalizimi i programeve të edukimit për të drejtat e njeriut nuk është në nivelin e duhur; u mungojnë mbështetja e duhur financiare dhe rritja e fondeve. Ne jemi të bindur se me banderola, me reklamime televizive nuk përmbushet misioni i OJQ-ve, siç është bërë praktike e

deritashme. Me strategji duhet siguruar koordinim, transparencë, llogaridhënie, efikasitet dhe të OJQ-ve. Nismat që mbi OJQ të vendoset kontrolloi shtetëror dëmton shumë demokracinë dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës.

k. Organet legjislative, ekzekutive dhe organet e gjyqësisë nuk janë të përfshirë në masë të duhur në aftësi për të qenë të aftë dhe objektiv në mbrojtjen, respektimin, promovimin dhe fuqizimin e të drejtave të fëmijës. Me strategji duhet siguruar që këto organe duke shfrytëzuar përvojën e shteteve të zhvilluara të përfshihen në trajnime dhe aftësi. Kjo veçmas vlen për deputetët, shërbimin policor, avokatët, gjyqtarët, inspektorët, punëtorët social dhe punëtorët tjerë administrativ.

ll. Mjedisi për rreth Kosovës, po ashtu është i pafavorshëm, sepse:” Antisemitizmi marshon sërish në Ballkan, ...<sup>9</sup>”, kufijtë e pakontrolluar kanë ndikuar që Kosovë të jetë vend transit për drogë, prostitucion, trafikim të femrave, etj. Me Strategji duhet kërkuar zgjidhje përkatëse me rrezatime pozitive nga Kosova drejtë rajoneve të Ballkanit.


## **II. Katër etapa kryesore të hartimit , zbatimit dhe të vlerësimit të strategjisë nacionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës**

Përpilimi i strategjisë nacionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës është një proces kompleks. Ky proces kërkon një qasje sistemore, që do të thotë vështrim të shumë anshëm, nga shumë kënde dhe aspekte, një qasje inter dhe shumë disiplinare. Karakteri inter dhe multidisiplinar del nga vet natyra dhe filozofia e të drejtave të njeriut. Për të operacionalizuar këtë proces kompleks dhe të ndërlikuar, imponohen katër etapa kryesore:

- I. Espertiza e gjendjes së drejtave të njeriut / fëmijës në Kosovë
- II. Përgatitja e strategjisë nacionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
- III. Zbatimit të strategjisë nacionale me mundësi të pilotimit disa aspekteve
- IV.** Evaluimi dhe raportimi për gjendjen e të drejtave të fëmijës

---

<sup>9</sup> Shih më gjërësisht: Oseku, Sh. Antisemitizmi marshon sërish në Ballkan,



**Sk .1. Organigrama i përgatitjes së strategjisë**

## **2.1. Ekspertiza e gjendjes së drejtave të njeriut në Kosovë**

Në ekspertizë do të përfshihen

2.1.1 Konteksti gjeografik, historik, demografik ,politik, social dhe ekonomik

2.1.2 Pasqyra e punimeve për gjendjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës në Kosovë për periudhën 1999 – 2001)

2.1.3 Pasqyra e institucioneve që punojnë me të drejtat e njeriut dhe të fëmijës në Kosove

2.1.3.1. Rrjeti i Qendrave sociale

2.1.3.2. Rrjeti i institucioneve të mbrojtjes sociale e shëndetësore të

2.1.3.3 .Pasqyra e rrjetit të OJQ-ve që merren me avancimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës në Kosove

2.1.4 Pasqyra e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës me të cilat rregullohen të drejtat dhe liritë elementare të njeriut në Kosovë( analiza e zbatimit, organizimi i debateve)

2.1.4.1. Analiza e ligjeve të miratuara në Kosovë me të cilat rregullohen të drejtat dhe liritë elementare të njeriut dhe të fëmijës

2.1.4.2. Drejtat e njeriut dhe të fëmijës në kornizën kushtetuese të Kosovës

2.1.4.3. Të drejtat e njeriut dhe të fëmijës në Ligjin për arsimin fillore dhe të mesëm të Kosovës (

2.1.4.4. Të drejtat e njeriut dhe të fëmijës në Standardet e për Kosovën

2.1.5 Gjendja e të drejtave politike

2.1.6 Gjendja e drejtave civile

2.1.7 Gjendja e të drejtave ekonomike

2.1.8 Gjenda e të drejtave sociale

2.1.9 Gjendja e të drejtave kulturore

2.1.10. Gjendja e të drejtave të zhvillimit të qëndrueshëm

## **2.2. Përpilimi startegjisë nacionale për fëmijë**

SNFK duhet të jetë rezultat e një pjesëmarrjeje me bazë të gjërë, sepse duke i përfshirë edhe organizatat nxënësve, organizatat e rinisë, institucionet, OJQ –të , organizatat konfesionmale, bashkësitë etnike, organizatat e ndryshme humanitare, organizatat e të drejtave të njerit dhe të fëmijës etj, krijohet ndjenja e pronësisë. Për këtë qëllim do të

formohen grupe e punës sipas fushave të ndryshme dhe sipas niveleve. Strategjia e përpiluar duhet të jetë prodhim i një konsensusi të gjerë, meqë vetëm ashtu sigurohet zbatimi saj efikas në praktikë.

**Bazë nisëse për hartimin e saj do të jenë standardet ndërkombëtare , standardet e evropiane dhe standardet nacionale, veçmas : Standardet për Kosovën.**

Drafti i SNFK do të diskutohet në nivele dhe në struktura të ndryshme shkencore profesionale, etnike, konfesionale, gjinore, moshore etj.

**Pas diskutimeve të zhvilluara do të përpilohet drafti final i SNFK i cili do të vlerësohet në një konferencë ndërkombëtare që do të zhvillohet në shtator të vitit 2006. Pas Konferencës së mbajtur SNFK do t'i dërgohet në miratim Kuvendit të Kosovës.**

### **2.3. Përgatitja e planeve të veprimit - pjesë integrale e strategjisë**

**- kohezioni social i orientuar drejtë “shoqërisë mike të fëmijëve”.**

Planet e veprimit duhet të sigurojnë “ pjesëmarrjen, promovimin dhe mbrojtjen e fëmijëve” .Objektivat e planeve të veprimit duhet të jenë:

- + kontrollimi asaj së çfarë është bërë me fëmijët dhe ambientin ku ata jetojnë
- + propozimi i strategjive të përshatshme për bashkëpunim ndërmjet sektorit publik( në nivel komëbëtar dhe lokal) dhe në sektorin privat dhe vullnetar, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët;
- + përcaktimi i konturave të një shoqëria miqësore për fëmijët, d.m.th. shoqëri në të cilën familjet janë në gjendje t'i përmbushin detyrat e tyre ndaj fëmijëve në mënyrë pozitive dhe të qartë, dhe në të cilën forcat demokratike i mbrojnë fëmijët në mënyrë adekuate ndaj çdo mënyre të eksploatimit

Tre element kryesor ku duhet përqendruar punën në plane janë:

- + fëmijët dhe ambienti
- + fëmijët dhe përkujdesja ndaj tyre gjatë ditës
- + sistemet përkrahëse sociale për fëmijët e rrezikuar, apo të cilit kanë qenë viktima të abuzimit, dhunës dhe të eksploatimit.

Planet e veprimit duhet të fokusohen edhe në çështje vijuese specifike:

- + Kontrolli i situatës së fëmijëve endacakë

- ✚ Identifikimi, rehabilitimi, aftësimi i fëmijëve që shfrytëzohen për çështje ekonomike
- ✚ Organizimi i trajnimeve dhe integrimi i fëmijëve të pafavorizuar
- ✚ Sigurimi i qasjeve të reja ndaj fëmijëve të përfshirë në delikuencën e të rinjëve
- ✚ Përcaktimi i qartë i vendit të familjes në shoqëri
- ✚ Përcaktimi i politikave të shëndetit publik lidhur me fëmijët
- ✚ Parandalimit dhe trajtimet e herëshme të varshmërisë ndaj alkoolit
- ✚ Të luftuarit të eksploatimit komercial seksual të fëmijëve ( duke e përfshirë edhe internetin)
- ✚ Edukimin dhe përkujdesjen për edukim
- ✚ Masat kundër keqtrajtimit të fëmijëve
- ✚ Situata e fëmijëve të cilit jetojnë nën përkujdesje institucionale
- ✚ Pasojat sociale të analfabetizimit fëmijët të cilit jetojnë jashtë ambientit të tyre familiar
- ✚ Fëmijët në rrethan të veçanta ( përjashtimi social, emigrantët, fëmijët me aftësi të kufizuara)
- ✚ Trafikimi i fëmijëve
- ✚ Pabarazia gjinore
- ✚ Edukimi dhe arsimimi ndër dhe multikulturor
- ✚ Përkrahja dhe mbrojtja e fëmijëve asocial
- ✚ Ligji mbi familjen lidhur me fëmijët dhe posaqërisht( kontaktet lidhur me fëmijë; statusi ligjor fëmijëve lidhur me prejardhjen , atësia , amësia; fëmijët e ndarë nga prindërit; çështja e bashkimit të tyre, perspektiva e fëmijëve me nevoja të veçanta).

#### **2.4. Evaluimi**

Me qëllim evaluimi do të formohet Komiteti Nacional për Përcjelljen dhe Evaluimin e gjendjes së drejtave të fëmijës - **KNPEGJDF** . Komiteti do të përbëhet nga 10 ekspertë. Do të takohet tri herë në vit. Secili element do ta ketë aktivitetin nisës( konfrenecën për shtyp, seminarë, materialet e publikuara në internet). Komiteti do të raportojë për gjendjen e të drejtave të fëmijës. Projektet, raportet dhe pakot trajnuese do

të prezantohen në “ Panairën e Idevë “ ose në “ Tregun për Veprim”<sup>10</sup>, Agjencitë e përfshira në zbatimin e programit dhe ekspertët nga grupet kryesore” do të kenë mundësi të prezantojnë projektet, të përgjigjen në pyetje, ofrojnë këshilla dhe të diskutojnë më tutje për mënyrat e veprimit.

Rezultatet e një Programi ( shuma e planeve të veprimit) në secilën fushë do të jenë<sup>11</sup>:

- ✚ shembuj të një praktike të mirë
- ✚ pako aftësuese
- ✚ këshilla teknike
- ✚ bartja e njohurive dhe e menyrave të punës
- ✚ zhvillimi i politikave të përbashkëta
- ✚ nxitje për veprim edhe në të ardhmen

## **2.5. Komisionet , trupat dhe grupet e punës**

Hartimi i Strategjisë nacionale do të sponsorohet nga Qeveria e Kosovës apo Kabineti i Kryemimistrit të Kosovës<sup>12</sup>

Me qëllim të ekspertizës së sofistikuar dhe të përcaktimit, definimit dhe të artikulimit kreativ të Strategjisë nacionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës do të formohen komisionet dhe grupet e punës në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin rajonal.

Në nivelin qendror do të formohet : Komisioni a këshilli nacional për të drejtat e fëmijës  
Këshilli nacaonale / komisioni/ do t’i formojë shtatë nënkomisine a nëkëshilla rajonalë.

Këshilli a Komisioni nacional do t’i formojë grupet e punës në përbërje: Grupi për legjislatore; grupi për të drejta politike, grupi për të drejta ekonomike, grupi për të drejta sociale; grupi për të drejta kulturore; grupi për të drejta mjedisore dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Grupet në përbërje të ngjajshme do të formohen edhe nivele rajonale.

---


<sup>10</sup> Nociione të huazuara nga Strategjia evropiane për fëmijët


<sup>11</sup> Shih: Strategjia evropiane për të drejta e fëmijës

<sup>12</sup> Do t’ ishte edhe një kontribi i madh në realizimin e standardeve dhe krijimine e një klime shumë të përshatshme dhe të qëndrueshme politike në Kosovë; dhe të një kohozioni stabil dhe qëndrueshëm social.



2.5.1. Skema organizative e komisioneve dhe gupeve të punës për hartimin SNFK





**Komisioni a këshillit nacional për hartimin e SNFK ,do të përbëhej nga përfaqësuesit e këtyre institucioneve**

1. Përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë
2. Përfaqësuesi i Ministrisë për Punë dhe Punë Sociale
3. Përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë
4. Përfaqësuesit i Ministrisë Ambientit
5. Përfaqësuesi i Ministrisë Financave
6. Përfaqësuesi i Ministrisë për Minoritete
7. Përfaqësuesi i Ministrisë për Kulturë, Sport dhe Çështje Rezidenciale
8. Përfaqësues i Zyrës Ligjore
9. Përfaqësues i grupit të punës për standarde
10. Përfaqësuesi i Kabinetit të Kryeministrit të Qeverisë
11. Përfaqësuesi i UNMIK-ut
12. Përfaqësuesi i UNICEF-it
13. Përfaqësuesi i Save the Children
14. Përfaqësuesi i KEC-t
15. Përfaqësuesi i Këshillit për të Drejta e njeriut
16. Përfaqësuesit e bashkësisë fetare islame
17. Përfaqësuesit e bashkësisë fetare katolike
18. Përfaqësuesit e bashkësisë ortodokse
19. Përfaqësuesi e bashkësisë serbe
20. Përfaqësuesit e bashkësisë boshnjake
21. Përfaqësuesi i bashkësisë turke
22. Ombuds - personi
23. Përfaqësuesi i SHPK-s

**Komisionet rajonale:**

1. Përfaqësuesi i Zyreve rajonale të Arsimit
2. Përfaqësuesit e Drejtorive komunale për arsim dhe shkencë
3. Përfaqësuesit të OJQ që veprojnë në rajon (3-5 përfaqësues)
4. Përfaqësues të Këshillit të trajnerëve për të drejta e njeriut të rajonit

5. Përfaqësues të drejtorisë komunale për kulturë, rini sport
6. Përfaqësues të drejtorive komunale për shëndetësi
7. Përfaqësues i prindërve
8. Përfaqësues i SHPK-s
9. Qendra për Punë Sociale
10. Përfaqësues të konfesioneve

Në vitin 2005 do të përfundonte ekspertiza mbi gjendjen e të drejtave të fëmijës në Kosovë ( pa ashtu do të përgatitej një Raport i detajuar për gjendjen e të drejtave të fëmijës), ndërsa në vitin 2006 do të hartohej. Strategjia nacionale për të drejtat e fëmijës e cila do të prezantohej edhe në një Konferencë ndërkombëtare në shtator 2006

Hartimi i planeve të veprimit dhe i programeve të cilat do të jenë pjesë e strategjisë do të fillonin në shtator të 2006 dhe do të përfundonin në mars të vitit 2007. Vlerësimi i zbatimit të planeve të veprimit do të fillonte në mars të vitit 2007, ndërsa raportet e para do të përgatiteshin pas tre muajsh.

### 3. Buxheti i nevojshëm për hartimin e Strategjisë nacionale për fëmijët e Kosovës

#### a. Buxheti i nevojshëm për ekspertizë

Nr.	Përshkrimi aktiviteteve	Njësia		Vlera në € për njësi	Gjithsej
		Njësia	Numri		
1.	Përgatitja e draftit të Projektit për hartimin e Strategjisë( shkrimi, përkthimi në gjuhën e angleze, serbe dhe turke)	Drafti	4	200	800
2.	Formimi i trupave për ekspertizë te gjendjes dhe përpilimin e strategjisë	Trupi	30	500	15.000
3.	Organizimi i debateve për Draft projektin	Takime	3	50	150
4.	Botimi i Draftit të projektit në katër gjuhë)	Ekzemplarë	500	3	1500
5.	Analiza e punimeve, materialeve, raporteve të shkruara për gjendjen e të drejtave të fëmijës në Kosovë	Analizë	1	1000	1000
6.	Përpilimi i pasqyrës së institucioneve të cilat merren me gjendjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës në Kosovë	Pasqyra me vlerësim	1	500	500
7.	Analiza e Rrjetit të Qendrave të për sociale për punë sociale	Analiza me vlerësim	1	500	500
8.	Rrjeti i institucioneve për përkujdesje dhe mbrojtjes sociale e shëndetësore - SWOT analiza e punës së institucioneve për përkujdesje dhe mbrojtje sociale	Analiza me vlerësim	1	500	500
9.	Pasqyra e rrjetit të OJQ-ve që merren me avancimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës në Kosove - SWOT analiza e punës së OJQ-ve	Analiza me vlerësim	1	500	500

10.	Pasqyra e ligjeve specifike për të drejtat e e njeriut dhe të fëmijës me vlerësim	Pasqyra me vlerësim me theks të veçantë në zbatueshmëri	1	1000	1000
11.	Gjendja e të drejtave politike dhe civile e fëmijëve në Kosovë( përgatitja e projektit, instrumenteve të hulumtimit, organizimi i hulumtimit dhe raportimi)	Raportimi për rezultat e hulumtimit	1	5000	5000
12.	Gjendja e të drejtave ekonomike, sociale, dhe kulturore e fëmijëve në Kosovë ( përgatitja e projektit të hulumtimit, instrumenteve të hulumtimit, organizimi i hulumtimit, raportimi)	Raportimi për rezultatet e hulumtimit	1	8000	8000
13.	Hulumtimi I gjendjes së drejtave të njeriut dhe të fëmijëve me nevoja të veçanta	Raportimi	1	5000	
14.	Gjendja e mjedisit dhe e të drejtës në zhvillim të qëndrueshëm( përgatitja e instrumenteve, organizimi i hulumtimit, raportimi)	Raportimi për rezultatet e hulumtimit	1	5000	5000
15.	Hulumtimi i marrëdhënieve ndëretnike	Raporti	1	5000	5000
16.	Monitorimi i punimeve të botuara në mediat e shkruara- gazetat ditore	Raportimi	1	3000	3.000
17.	Përgatitja e botimit për gjendjen e të drejtave të njeriut/ fëmijës në Kosovë ( në gjuhën shqipe, serbe-boshnjake, turke dhe angleze)	Versioni I parë	1	10.000	10.000
18.	Këshillime, recensionit dhe redaktimi shkencor	Recensionit	1	2.000	2000
19.	Botimi i librit	Ekzemplari	2000	6	12.000
20.	Mjetet e përgjithshme ekspertizë				71.350

#### B. Buxheti i nevojshëm për hartimin e SNFK

Nr.	Përshkrimi aktiviteteve	Njësia		Vlera në € për njësi	Gjithsej
		Njësia	Numri		
1.	Përcaktimi i vizionit, misionit dhe identifikimi i problemeve	Punëtori 6 planifikimi me Metodën e Kornizës me 25 ekspertë	25 pjesë.X 6 ditë+3eks 150 e.X6 ditë	(25 p.x 6 ditëX35 E. akom.=5250)+ (2 mod.X150 eurox 6 ditë=1800)	7.050
2.	Organizimi i diskutimeve për vizionin, misionin. dhe problemet e identifikuar	Tryeza	5	5x 50	250
3.	Përgatitja e programit nacional të edukimit për të drejtat e njeriut/ fëmijës : në gjuhën shqipe; serbe – boshnjake , gjuhën turke dhe gjuhën angleze	Programi	1	3000	3.000
4.	Organizimi i debatit për: Programin nacional të edukimit për të drejtat e njeriut / fëmijës	Debate	6	200	1.200
5.	Përgatitja për botim të Programit nacional të edukimit për të drejtat e njeriut dhe fëmijës	Programi	1	6000	6.000
6.	Këshillime, recensionit dhe redaktimi shkencor	Recensionit	1	500	500
7.	Botimi	Ezemplari	1000	5	5.000
8.	Përgatitja e Planit të veprimit për zbatimin e Programit nacional të edukimit për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës	Plani I veprimit	3(veprimi për tri vite)	500	1.500
9	Përgatitja e programit të bashkëpunimit të OJQ	Programi	1	1.000	1.000

10.	Përgatitja e Strategjisë nacionale për mbrojtjen , respektimin dhe avancimin I të drejtave të fëmijës në Kosovë ( në gjuhën shqipe, serbe-boshnjake, turke dhe angleze)	Drafti	1	10.000	1.000
11.	Organizimi e debatit për Draftin e Strategjisë	Debati	8	200	2.400
12.	Përfshirja e vërejtjeve, sugjerimeve, nga debatet e organizuara:	Dokumenti	1	500	500
13.	Këshillime, recensionit dhe redaktimi shkencor strategjisë nacionale	Recensionit	1	2000	2.000
14.	Botimi I strategjisë nacionale	Ekzemplari	1500	8	12.000
15.	Organizimi I Konferencës ndërkombëtare	Konferenca	2	2	20.000
16.	Përgatitja e elaboratit për themelimin e Institutit Rajonal për të drejtat e fëmijës	Elaborati	1	5.000	5.000
17.	Përgatitja e planeve të veprimit për zbatimin e strategjisë	Plani I veprimit	3	1000	3.000
18.	Monitorimi dhe vlerësimi	Raport	7	1.000	7.000
	Gjithsej				93.400
	Total				164.750

### Referencat:

- Agi, M.(1979) Rene Cassin fantassin des Droits de l'Homme. Paris
- Amnesty International(2000).: Manual për fillimin e edukimit të të drejtave të njeriut. Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut
- Annan, K(1999):” Two concepts of sovereignty”, The Economist, 18 September 1999
- Asquit, S.,Juvenile Justice and Juvenile Delinquency in Central and Eastern Europe – A Review – Centre for the Child and Society. University of Glasgow.<http://eurochild.gl.ac.uk>
- Beetham, D.(1999), Democracy and human rights, Polity Press
- Bell,G.H.(1994) (ed) Educating European Citizens
- Best, F(1990) The Sciences, Ethics, Human Rights and Education. Donau- schingen seminar No 48. Strasbourg: Council of Europe.( DECS/EGT(90)23)
- Birzea,C.(2000) Education for Democratic citizenship:A lifelong learning perspective, Council for Cultural Co – operation, Strasbourg
- Boyle, A.,Anderson, M.R.(1996): Human rights approaches to environmental protection: An overview, Clarendon Press, Oxford
- Braktisja e fëmijëve në Kosovë (2003), Qeveria e Kosovës \_government of Kosovo – Vlada Kosova, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Prishtinë
- Brennan, J & McGeevor, P.(1990) Ethnic Minorities and the Graduated Labor Market. London. Comision for Racial Equality.
- Choices for the poor, UN Development Programme, New York, 2001
- Connel, R.W, Gender dhe power, Stanford University Press
- Council of Europe(1998) European strategy for Children. Recommendation 1286(1996) doc.8287
- Council of Europe (1994).Final report of the study group on the street children, Strasbourg.
- Council of Europe;Education for Democratic Citizenship, [www.coe.int/T/E](http://www.coe.int/T/E)
- Council of Europe(1992) The Human Rights Album.Strasbourg

Cowell, K. & Howe, R. B. (1995) Variations in support for children's rights among Canadian youth, *International Journal of Children's Rights*, 3.2, pp 189 -96

Crick, B. (2000)., *Essays on citizenship*, Continium

Declaration on the Rights of Peoples to Peace, A/RES/39/II, UN General Assembly, 1984

Deçiji rad na Kosovu. Studija o deci radnicima, UNICEF, 2004

Ecuria e rasteve të ndarjes së prindërve dhe besimit të fëmijëve në periudhën 2000 - 2004 (2005). *Shoqata e Juristëve "Norma"*. USAID, OFDI

European Initiative for Democracy and Human Rights. Guidelines for grant applicants responding to the call for Proposals for 2004. Combating Racism & Xenophobia & Promoting the rights of Minorities, Europeaid/ 120883/C/g.

Fëmijët që punojnë në rrugë në Shqipëri (2002). Vlerësimi I shpejt në qytetet Tiranë, Shkodër, Vlorë, IPEC

Fiekkoy, M., *A voice for Children – Speaking as their Ombudsman* (1991), UNICEF

Freeman, M. (1988) Taking children's rights seriously, *Children and Society*, 4, pp. 299-319

Fullan, M. (2002) *Forcat e ndryshimit. Depërtim në thellësitë e reformës arsimore*, SOROS, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

Gardner, H. (2003) *Mendja e pashkolluar*, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë

Gardner, H. (2003) *Mendja e disiplinuar*, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë

Georgesescu, D. (1994) *Strategies for Interculturally – Oriented Civics Teaching at Primary and Secondary Level: report of the experimental phase*. Strasbourg: Council of Europe. (DECS/SE/DHRM(94)11)

Government strategy concerning the protection of the child in difficulty (2001-2004). <http://www.roembus.org/english/communities/copii/strategie-copii.htm>

Hall, J. (ed) (1971) *Children's Rights: Towards the Liberation of the Child*. London.

Heater, D. (1984) *Human Rights Education in Schools: concepts, attitudes and skills*. Strasbourg: Council of Europe.

Hyseni, H. etj. (2004); *Të drejtat e fëmijës. Manual për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës*. KEC, Prishtinë

Human Rights Education Newsletter, No.29. Centre for Global Education, University of York, UK 2001

Human Development Report, 2000. United Nations Development Programme, Oxford University Press, USA, 2000

ILO Convention 182 (1999), Ad Geneva

R190 Worst Form of Child Labour Recommendation (1999)

Leary, V. (1998) "Globalization and Human Rights", *Human Rights, New Dimensions and Challenges*, UNESCO, Paris

Lodgaard, S. (2000) "Human security: concepts and operationalization", Norwegian Institute of International Affairs, unpublished

Mato, E. etj. (2003); *Edukimi ndërkulturor dhe i të drejtave të njeriut në shkollë. "Një botë për t'u zbuluar"*. Manual trajnimi për mësuesit e shkollës e tëvjeçare, UNESCO, ISP, Tiranë

Manual for Rapid Assessment (2003). *Trafficking in Children Exploitation in the Balkans and Ukraine*, IPEC

Mertus, J, Flowers, N, Dutt, M, (1999): Local action, global change, UNIFEM and the Center for Women's Global Leadership

Kennedy, K (1997); Citizenship education and modern state, Falmer Press

Learning to live together: Good practices in Schools, UNESCO, IBE, GTZ... Selections from IBE's Related Databank

Miller, B. (2002), Unë mund të mësoj. Udhëzues për mësues.. Paaftësia në mësim dhe mungesa e vëmendjes, QPEA, Ferizaj

Miller, B. (2004) Komunikimi me fëmijë. Doracak për prindër dhe arsimtarë, QPEA

Miller, B.: (2003); Si të krijohet kontakti i sukseshëm me nxënësit. Doracak për arsimtarë, QPEA

Miller, B. (2004); Komunikimi me fëmijë. Doracak për prindër dhe arsimtarë, QPEA

Molteno, M. (2003) Të fillosh i ri. Parimet dhe praktika në zhvillimin e fëmijërisë së hershme. Save the Children UK. Prishtinë. Përkthim në shqip. Mat. i shumëzuar.

Muka, P. etj. (2003); Edukimi ndërkulturor dhe I të drejtave të njeriut në shkollë. Manual për trajnerët. UNESCO, ISP, Tiranë.

National Strategy for Children ( 5 year plan (2001). Republic of Albania. National Committee on Women and Family

Nevenka L. etj (2003) Odgoj i obrazovanje za ljudska prava I demokraciju. Seminar za predsjednike ( tajnike) županskih koordinacija za ljudska prava. Provedba nacionalnog programa odgoja i obrazovanja za ljudska prava. [http://www.ljudskaprava-vladarh.hr/Seminar- Jelacic.htm](http://www.ljudskaprava-vladarh.hr/Seminar-Jelacic.htm)

Oliver, D & Heater, D., (1994) The foundations of citizenship, Harvester Wheatsheaf

Osler, A. & Starkey, H (1996): Teacher Education and Human Rights, London

Our creative diversity, report of the World Commission on Culture and Development, UNESCO, 1995

Pakicat dhe mbrojtja e të drejtave të tyre në Shqipëri ( konventa, legjislacion, raporte dhe materiale shpjeguese, mbi pakicat kombëtare). Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut Report 2000, Amnesty International Publication, UK, 2000

Rapid Assessment of Trafficking in Children for Labour and Sexual Exploitation in Albania (2003)

Pettiti, L, Meyer - Bisch, P, " Human rights and extreme poverty, 7-10 February 2001

Rotschild, E, ' Human security", DAEDALUS, the Journal of the American Academy of Arts and Sciences, Vol.124.No3. Summer 1995

Ramber (2001): I. Violence against young women in Europe, seminar report, Council of Europe

Raporte të punës hulumtuese të dhjet qendrave (2004), Nr.4 Kolekcioni nr.4, Vjetare 2003., Qendra për mbrojtje grave dhe të fëmijëve, Prishtinë

Setting up a European Ombudsman for Children doc. 8552 Council of Europe Parliamentary Assembly, 1999

Street Working Children in Albania ( 2003) IPEC, Tirana

Studimi i statusit mikronutritiv në Kosovë, UNICEF, IPVK, Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar hulumtues për nutricion dhe ushqim- Itali, 2002

Tyler, J, Berry, A ( 2001): Time to abolish war, a youth agenda for peace and justice, Hague Appell for Peace, European Youth Foundation, 2001

Të drejtat e fëmijëve në shtëpi të nxënësve kosovarë (2004). Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Prishtinë

Wall ,H.(?) Të drejtat e njeriut. Për mësuesit e shkollës tetëvjeçare, Qendra Shqiptare e dokumentacionit për të Drejtat e Njeriut, Tiranë  
 The Global Movement for Children, [www.gmfc.org](http://www.gmfc.org).  
 The State of the World's Children (2000), doc.8552, UNICEF  
 "Trafficking in women, a comprehensive European strategy". informacion sheets, European Commission  
 Situation analysis of children and women in Kosovo (2004) UNICEF  
 Standardet për Kosovën,(2003): mat. i shumëzuar, Prishtinë  
 Standardi za Kosovo(2003),umnoženi material, Prishtinë  
 Symonides, J., Sport in service of human rights, World Conference on Education and Sports for Culture of Peace, Unesco, Paris, 1999  
 Spiliopoulou, S.(1998); Arsimi për të Drejtat e Njeriut. Të arriturat dhe Sfidat. Instituti për të Drejtat e Njeriut.Universiteti I Abo Akadenisë në Bashkëpunim me Komisionin Kombëtarë Finlandez për UNESCO-n dhe UNESCO. Përkthim në shqip; Projekti Finlandez për të Drejtat e Njeriut, Prishtinë, Kosovë  
 "Young people in changing societies", Regional Monitoring Reports,No 7, Florence:unicef Innocentii Research Center, 2000  
 UN Commission on Human Rights , Resolution on the Promotion of the peoples to Peace, 25 April 2001  
 Willams, S. et all(1994):The Oxfam gender training manual, Oxfam Publication  
 World Communication and Information Report, UNESCO publishing , 1999

**Web faqet:**

Antisemitism and Xenophobia Today, [www.axt.org.uk](http://www.axt.org.uk)  
 The Anti- Defamation Leagues, [www.adl.org](http://www.adl.org)  
 The European Commission against Racism and Intolerance of the Council of Europe [www.ecri.coe.int](http://www.ecri.coe.int)  
 La Ligue Internationale contre le Racisme et l' Antisemitisme (LICRA), France, [www.licra.com](http://www.licra.com)  
 SOS Racisme( France), [www.sos-racisme.org](http://www.sos-racisme.org)  
 UNITED for Intercultural Action –the European Network against nationalism,racism, fascism and support of migrants and refugees, [www.xs4all.nl/~united](http://www.xs4all.nl/~united)  
 The European network against racism, [www.enar-eu.org/](http://www.enar-eu.org/)  
 The European Monitoring Centre on Racism and Xenophobia(EUMC), [www.eumc.eu.int](http://www.eumc.eu.int)  
 Minorities of Europe, [www.moe-online.com](http://www.moe-online.com)  
 Young Women from Minorities, [www.wfmonline.org](http://www.wfmonline.org)  
 The European Roma Rights Centre, [www.errc.org](http://www.errc.org)  
 The International Romani Union, [www.romaniunion.org](http://www.romaniunion.org)  
 Building Bridges for Learning, Youth Forum, Brussels, 1999.Education for All – conry reports, 2000., <http://www2.unesco.org>  
 World Education Report, [www.unesco.org](http://www.unesco.org).  
 Human Development Report 1994, UN Development Programme, [www.undp.org](http://www.undp.org).  
 Human Development Report 1999/2001.Un Development Programme, [www.undp.org](http://www.undp.org)  
 BosellmannK., Human rights and the environment:redefining fundamental principles, [www.arbid.unimelb.edu.au](http://www.arbid.unimelb.edu.au)

Caring for Earth, The World Conservation Union Programme, World Wide Fund for Nature, [www.ciesin.org/IC/iucn](http://www.ciesin.org/IC/iucn).

The Council of Europe environment programme, [www.nature.coe.int](http://www.nature.coe.int).

The 1994 draft Declaration of Principle on Human Rights Environment [www.umn.edu/humanrts/instate/1994-dec.htm](http://www.umn.edu/humanrts/instate/1994-dec.htm)

The Earth Charter initiative, [www.earthcharter.org](http://www.earthcharter.org)

Worldwatch, [www.worldwatch.org](http://www.worldwatch.org)

OECD –DAC Gender, [www.oecd.org/dac/gender](http://www.oecd.org/dac/gender)

UNESCO, [www.unesco.org/gender](http://www.unesco.org/gender)

UN Statistics Division Gender Statistics, [www.un.org/depts/unsd/gender](http://www.un.org/depts/unsd/gender)

UNIFEM, [www.undp.org/unifem](http://www.undp.org/unifem)

Women Watch, [www.un.org/womenwatch](http://www.un.org/womenwatch)

EWL, [www.womenlobby.org](http://www.womenlobby.org)

Women Against Violence Europe, [www.wave-network.org](http://www.wave-network.org)

Men Against Violence Against Women, <http://menagainstvioence.tripod.com>

Young Women from Minorities, [www.wfmonline.org](http://www.wfmonline.org)

UN, World Bank, ILO Policy, A global alliance for youth employment: recommendations of the High Level panel of the UN Secretary – General’s Youth Employment Network, [www.un.org/esa/socdev/youthemployment/index.html](http://www.un.org/esa/socdev/youthemployment/index.html).

The World Health Report; World Health Organization, [www.who.int/whr/](http://www.who.int/whr/)  
[www.humansecuritynetwork.org](http://www.humansecuritynetwork.org)

Charter of the UN, [www.un.org/peace](http://www.un.org/peace)

The Canadian Department for Foreign Affairs and International Trade ( DFAIT), [www.dfait-maeci.gc.ca/foreignp/humansecurity](http://www.dfait-maeci.gc.ca/foreignp/humansecurity)  
[www.humanrights.coe.int/media](http://www.humanrights.coe.int/media)

Voices of youth explore children and war, [www.unicef.org/voy/meeting/war-exp2.html](http://www.unicef.org/voy/meeting/war-exp2.html)

The World Jewish Congress, [www.wjc.org.il](http://www.wjc.org.il)

The International Lesbian and Gay Association, [www.ilga.org](http://www.ilga.org)

The Institute for Lesbian and Gay Strategic Studies, [www.iglss.org](http://www.iglss.org)

“Facts on sexual orientation and sexual prejudice”,  
<http://psychology.ucdavis.edu/rainbow>

The International Lesbian and Gay Youth Organization, [www.iglyo.org](http://www.iglyo.org)

International Institute for Democracy, [www.iidemocracy.coe.int/](http://www.iidemocracy.coe.int/)

Inter – parliamentary Union, [www.ipu.org/](http://www.ipu.org/)

Politeia Network for Citizenship and Democracy in Europe, [www.politeia.net](http://www.politeia.net)

Union Romany(Spain), [www.unionromani.org](http://www.unionromani.org).

Patrin Web Journal, [www.geocities.com/Paris/5121/patrin.htm](http://www.geocities.com/Paris/5121/patrin.htm)

The World Institute on Disability, [www.wid.org](http://www.wid.org)

The United Nations High Commissioner for Refugees: [www.unhcr.org](http://www.unhcr.org)

The portal for the promotion and protection of the rights of migrants, [www.december18.net](http://www.december18.net).

Association des Traillleur Magrebins en France, [www.atmf.org](http://www.atmf.org)

SOLIDAR, [www.solidar.org](http://www.solidar.org)

The European Council on Refugees and Exiles, [www.ecre.org](http://www.ecre.org)

The United Religions Initiative, [www.uri.org](http://www.uri.org)

Baha’I Faith, [www.bahai.org](http://www.bahai.org)

On Islam – site of the 21 Project, [www.islam21.net](http://www.islam21.net)  
The Forum against Islamophobia and Racism, [www.fairuk.org](http://www.fairuk.org)  
The Sikhism home page, [www.sikhs.org](http://www.sikhs.org)  
Hindu Resource on-line, [www.hindu.org](http://www.hindu.org)  
The World Council of Churches, [www.wcc-coe.org](http://www.wcc-coe.org)  
Catholic Church- The Holy See website, [www.vatican.va](http://www.vatican.va)  
Eastern Orthodox Church, [www.russian-orthodox-church.org.ru](http://www.russian-orthodox-church.org.ru)  
Shamah:Jewish Network Information and discussion on the  
Internet,<http://shamash.org/about.shtml>  
[www.owl.ru/anna](http://www.owl.ru/anna)  
[www.greenpeace.org](http://www.greenpeace.org).  
<http://www.globalwitness.org>